

URDHËR 202, DATË 16.12.2005 TË KRYEMINISTRIT

PËR

FORCIMIN E TRANSPARENCËS, NËPËRMJET RITJES SË PËRDORIMIT TË INTERNETIT DHE PËRMIRËSIMIT TË FAQEVE EKZISTUESE TË INTERNETIT

Ndryshuar me: Urdhër Nr. 199, datë 26.10.2013, PËR NJË SHITESË NË URDHËRIN NR. 202, DATË 16.12.2005 të Kryeministrit "PËR FORCIMIN E TRANSPARENCËS, NËPËRMJET RITJES SË PËRDORIMIT TË INTERNETIT DHE PËRMIRËSIMIT TË FAQEVE EKZISTUESE TË INTERNETIT" Edi RAMA

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102 , të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative të republikës së Shqipërisë”,

Urdhëroj:

Ministritë dhe Institucionet, në varësi të Këshillit të Ministrave apo të Kryeministrit, përfshirë dhe prefektët, të krijojnë brenda datës 31 mars 2006, faqet e tyre në internet ose të përmirësojnë faqet ekzistuese në internet, për rritjen e transparencës, nëpërmjet përdorimit të internetit. Paraqitja e informacionit të jetë në gjuhën shqipe e anglisht dhe duhet të bëhet në mënyrë metodike e funksionale.

Institucionet e tjera në varësi të Këshillit të Ministrave që realizojnë shërbime për publikun, japin licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo kryejnë shërbime të tjera të ngjashme, të krijojnë faqet e tyre në internet, brenda të njëjtit afat.

Institucione të tjera në varësi të ministrive, të cilat nuk përfshihen në pikën 2, t’i përfshijnë të dhënat bazë, sipas përcaktimeve të pikës 5 të këtij urdhëri, në faqen e internetit të ministrisë nga e cila varen.

Faqja e internetit për çdo institucion, të ketë në adresë shkurtimin e emërtesës zyrtare të institucionit si dhe prapashtesën identifikuese: “gov.al”, sipas listës që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

Faqja e internetit ekzistuese apo e re, duhet të përmbajë, në mënyrë të detyrueshme:

- a. Stemën e Republikës së Shqipërisë dhe emërtesën zyrtare të Institucionit;
- b. Adresën e plotë të Institucionit;

- c. Numrin e telefonit, faksit dhe adresën e e-mail-it për kontaktin me ministrin/titullarin, anëtarët e organit drejtues, zëvendësministrin, zëvendëstitullarin dhe Sekretarin e Përgjithshëm.
- ç) Pjesën e programit të Qeverisë, që i përket Institucionit;
- d. Misionin dhe funksionet e institucionit, përfshirë edhe ato të institucioneve në varësi;
- dh. Skemën organizative të ministrisë/institucionit, përfshirë edhe atë të institucioneve në varësi;
- e. Legjislacionin bazë për organizimin, funksionimin dhe funksionet e institucioniit përkatës;
- ë. Të dhënat e përditësuara për veprimtarinë publike të ministrisë, institucionit, të dhëna për politika, akte ligjore e nënligjore në proces;
- f. Dokumentat strategjike, të miratuara në fushën e veprimit dhe funksionet e institucionit;
- g. Të dhënat e hollësishme, përfshirë CV-në e Ministrit apo titullarit, të zëvendësministrit apo zëvendëstitullarit dhe, sipas rastit, të Sekretarit të Përgjithshëm;
- gj. Deklaratat e pasurive, të detyrimeve dhe interesave të zyrtarëve dhe nëpunësve, sipas parashikimit ligjor;
- h. Emrin, numrin e telefonit, të faksit, dhe adresën e e-mail të drejtuesve të njërive (departamenteve, drejtorive të përgjithshme, drejtorive, sektorëve), brenda institucionit;
- i. Emrat, numrin e telefonit, të faksit dhe adresën e e-mail-it, të drejtuesve të njërive(departamenteve, drejtorive të përgjithshme, drejtorive, sektorëve) brenda institucionit;
- j. Listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku të përfshihen edhe:
- i. procedura dhe kushtet e perfitimit të tyre;
 - ii. dokumentacioni i nevojshëm dhe kostoja për realizimin e shërbimit;
 - iii. Formulari i aplikimit për çdo shërbim dhe udhëzuesi i plotësimit të tij;
 - iv. Afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar;
 - v. Afati dhe organi, ku bëhet ankimi në rast refuzimi të përgjigjes apo të mosofritit të shërbimit në afatin e detyrueshëm ligjor.
- l. Buxhetin e miratuar vjetor, të ndarë sipas zërave kryesore të shpenzimeve, dhe buxhetin faktik për vitin e kaluar;
- m. Të dhënat për shpenzimet operative, me periodicitet të paktën 3- mujor;
- ll. Datën e përditësimit të fundit të faqes së internetit dhe të faqeve kryesore, të shfaqur në fund të tyre;
- n. Listën e lidhjeve të domosdoshme me faqet e internetit të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve bashkëpunuese e të varësisë.

Informacioni i paraqitur në anglisht në faqet zyrtare të institucioneve duhet të përfshijë detyrimisht informacionin e përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, e “j” të pikës 5, të këtij urdhëri.

Përveç rasteve të veçanta të përcaktuar me ligj, faqet e internetit nuk duhet të përmbajnë reklama me karakter dhe qëllim tregtar.

Institucionet përkatëse të kenë një adresë e-mail-i, posaçërisht, për komunikimin me publikun dhe të ngarkojnë një person për të kontrolluar, rregullisht, të dhënat, e marra.

Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet e mësipërme për zbatimin e këtij urdhëri.

Urdhëri Nr. 164, datë 20.10.2004, i kryeministrit, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Zoti Ditmir Bushati, Ministër i Punëve të Jashtme www.punetejashtme.gov.al
www.mfa.gov.al
AKSHI 134.0.35.147

Zonja Mimi Kodheli, Ministër i Mbrojtjes www.mbrojtja.gov.al
www.mod.gov.al
AKSHI 134.0.35.189

Zoti Saimir Tahiri, Ministër i Punëve të Brendshme www.punetebrendshme.gov.al
www.moi.gov.al
AKSHI 144.76.67.207

Zonja Klajda Gjoshë, Ministër i Integritimit Evropian www.integrimi.gov.al
www.mie.gov.al
AKSHI 134.0.35.157

Zoti Shkëlqim Cani, Ministër i Financave www.financa.gov.al
www.minfin.gov.al
AKSHI 134.0.35.157

Zoti Edmond Haxhinasto, Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës www.transporti.gov.al
www.infrastruktura.gov.al
www.mppt.gov.al
AKSHI 134.0.35.159

Zonja Eglantina Gjermeni, Ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit www.turizmi.gov.al
www.mtkrs.gov.al AKSHI 134.0.35.148

Zoti Arben Ahmetaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
www.ekonomia.gov.al
www.mete.gov.al
AKSHI 216.55.105.147

Zonja Lindita Nikolla, Ministër i Arsimit dhe Sportit www.arsimi.gov.al
www.sporti.gov.al www.mash.gov.al
AKSHI 216.55.105.147

Zoti Nasip Naço, Ministër i Drejtësisë www.drejtesia.gov.al
www.justice.gov.al
SAN 134.0.63.98

Zonja Mirela Kumbaro Furxhi, Ministër i Kulturës www.kultura.gov.al
www.mtkrs.gov.al
AKSHI 134.0.35.203

Zoti Erion Veliaj, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinise www.sociale.gov.al
www.rinia.gov.al
www.mpcs.gov.al
AKSHI 134.0.35.145

Zoti Damian Gjijnuri, Ministër i Energjisë dhe Industrisë www.energjia.gov.al
www.mete.gov.al
AKSHI 198.154.228.179

Zoti Edmond Panariti, Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujërave
www.bujqesia.gov.al
www.mbumk.gov.al
AKSHI 134.0.35.210

Zoti Ilir Beqja, Ministër i Shëndetësisë www.shendetesia.gov.al
www.moh.gov.al
hostingalb 69.61.37.54

Zoti Lifter Koka, Ministër i Mjedisit www.mjedisi.gov.al

www.moe.gov.al AKSHI 134.0.35.208

Zonja Milena Harito, Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratës Publike

www.inovacioni.gov.al

www.administrata.gov.al

www.mitik.gov.al

AKSHI 216.55.105.147

z. Ilirjan Celibashi Ministër për Marrëdhëniet me Parlamentin

www.marredhenietmeparlamentin.gov.al

z. Bledi Cuci Ministër Shteti për Çështjet Vendore

www.ceshtjetvendore.gov.al